



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr.____/ 2025

PËR

LIRIMIN E FREKUENCAVE TË DIGITAL DIVIDENTIT DY (DD2)

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve televizive, që transmetohen nëpërmjet rrjeteve tokësore pas lirimit të brezit të frekuencave 700 MHz, përmes kompensimit të pjesshëm të kostove direkte që shkakton procesi i lirimit të brezit 700 MHz.
2. Ky ligj, ka për qëllim të krijojë kushtet për lirimin e Digital Dividentit Dy (DD2), që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive, dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme, sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave.

Neni 3

Përkufizime

1. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj, i licensuar nga AMA sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
2. “Operatori i rrjetit numerik” është OSHMA që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike e të shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin të të dhënave.
3. “AMA”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, që funksionon sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
4. “AKEP”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që funksionon sipas ligjit nr. 54/2024, datë 30.5.2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
5. “Kosto direkte” është kosto që shoqërojnë lirimin e brezit 700 MHz.
6. “Digital Divident Dy” janë frekuencat e brezit 694-790 MHz, që lirohen nga transmetimet numerike aktuale dhe që janë përcaktuar për përdorim nga rrjetet e komunikimeve të lëvizshme.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për mbulimin e pjesshëm të kostove të drejtperdrejta që shoqërojnë lirimin e brezit 700 MHz lidhur me rrjetet e transmetimeve numerike kombëtare të operatorëve të licensuar nga AMA dhe rrjetet e transmetimeve numerike të RTSH-së, vetëm për investimet e kryera që preken nga lirimi i brezit 700 MHz si dhe kostot për planin e komunikimit për informimin e publikut gjatë procesit të lirimit të brezit 700 Mhz.

KREU II

KRIJIMI, PËRDORIMI DHE NDARJA E KOMPENSIMIT FINANCIAR

Neni 5

Kompensimi financiar

1. Për vijimin e ofrimit të shërbimit mediatik audioviziv, sipas këtij ligji, dhe krijimin e kushteve për lirimin e Dividentit Numerik 2, jepet kompensim financiar për procesin e lirimit të brezit 700 MHz.
2. Kompensimi financiar është në vlerën 5,137,300 (pesë milionë, njëqind e tridhjetë e shtatë mijë

e treqind) Euro dhe përballohet nga buxheti i shtetit. Kompensimi financiar përfshin kostot direkte që lidhen me lirimimin e frekuencave të brezit 700 MHz si dhe kostot e komunikimit për njoftimin e publikut.

3. Masa e kompensimit financiar do të jetë 50% e totalit në fillim të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz dhe pjesa e mbetur 50% e totalit, në përfundim të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz.
4. Kompensimi financiar jepet nga buxheti i shtetit, në formën e transfertës, Autoritetit të Mediave Audiovizive.
5. Kompensimi për secilin prej operatorëve të rrjeteve numerike kombëtare të licensuar nga AMA, aktualisht përdorues të frekuencave të brezit 700 MHz, si dhe për rrjetet e transmetimeve numerike të RTSH-së, jepet nga AMA sipas tabelës së vlerësimit të kostove në lidhjen 1, që janë llogaritur sipas metodologjisë së paraqitur në lidhjen 2, të këtij ligji.

Neni 6

Ndarja dhe përdorimi i kompensimit financiar

1. Masa e kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij ligji, ndahet dhe përdoret si më poshtë:
 - a) 50 % e tij, ose 2,568,650 (dy milionë, pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Euro, jepet në avancë dhe përdoret për të mbuluar pjesërisht kostot për investimet që operatorët e rrjetit në transmetimet numerike dhe RTSH, kryejnë me qëllim lirimimin e brezit 700 MHz, për ndryshimin/përshtatjen e infrastrukturës së transmetimit nga procesi i lirimimit të brezit 700 MHz si dhe kostot për planin e komunikimit për informimin e publikut gjatë procesit të lirimimit të brezit 700 Mhz.
 - b) 50 % e tij, ose 2,568,650 (dy milionë, pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Euro, jepen në përfundim të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz.
2. AMA bën shpërndarjen sipas lidhjes 1 të këtij ligji, si dhe shpërndarjen për kostot e komunikimit duke respektuar parimin e objektivitetit, të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

Neni 7

Mënyra e administrimit të kompensimit financiar

1. Administrimi i fondeve të kompensimit financiar bëhet nga administrata e AMA-s.
2. AMA koordinon me operatorët e rrjeteve numerike kombëtare, të cilët përfitojnë nga kompensimi financiar sipas këtij ligji, dhe ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe kanë detyrimin për lirimimin e frekuencave të brezit 700 MHz.
3. AMA kryen analizën e ndarjes së kompensimit financiar, sipas nenit 5 të këtij ligji, si dhe bën verifikimin e lirimimit të frekuencave.
4. AMA kërkon në Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe ministrinë përgjegjëse për financat fillimisht transferimin e 50 % të vlerës totale në fillim të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz dhe 50 % në fund të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji.
5. Me marrjen e kërkesës, nga AMA sipas këtij neni, ministri përgjegjës për infrastrukturën i

- drejtohet Këshillit të Ministrave me kërkesën për akordimin e fondit nga buxheti i Shtetit.
6. Me miratimin e vendimit përkatës ministria përgjegjëse për financat transferon në llogari në e AMA-s shumën e fondit të kërkuar.
 7. AMA, menjëherë pasi konfirmon hyrjen e të ardhurave të kërkuara për kompensimin financiar në llogarinë e vet, kryen pagesën për subjektet që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas këtij ligji, vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.
 8. AMA raporton në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën për pagesat e kryera.

Neni 8

Kthimi i kompensimit financiar

1. Pas lirimit frekuencat e Digital Dividend 2, i kalojnë në administrim AKEP-it. AKEP jep në përdorim këto frekuenca për rrjete të komunikimeve elektronike të lëvizshme 5G, sipas parashikimeve në ligjin për komunikimet elektronike.
2. Kompensimi financiar i parashikuar në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji për t'u përballuar nga buxheti i shtetit, do të kthehet në buxhetin e shtetit përmes të ardhurave që përfitohen nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të caktuara për rrjete të gjeneratës së ardhme 5G, që derdhen menjëherë në buxhetin e shtetit.

Neni 9

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për infrastrukturën, AMA dhe AKEP për zbatimin e këtij ligji.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI

Tabela e Vlerësimit të kostove të kompensimit

(per tu plotesuar)

Metodologjia e llogaritjes së kompensimit

Metodologjia e llogaritjes së kostove të kompensimit është mbështetur në praktikat e mira të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe rezultatet e asistencës teknike të ofruar nga ekspertët e Bashkimit Evropian.

Metodologjia bazohet në stacionet e transmetimit sipas konfigurimit të rrjetit/eve ekzistuese dhe fuqisë së transmetimit si dhe çmimeve përkatëse për transmetuesit sipas fuqisë së transmetimit. Metodologjia grupon transmetuesit në grupe sipas fuqisë së transmetimit dhe merr parasysh situatën aktuale të rrjetit mbi bazën e raportimit të kryer nga vetë operatorët dhe verifikimit të kryer nga AMA.

Metodologjia supozon që:

- 60% e pajisjeve të instaluar do të ripërdoren pas rikonfigurimit të rrjetit/eve;
- Kostoja për rikonfigurimin vlerësohet të jetë 20% e kostos së produktit të ri (përfshirë transportin dhe punimet);
- Nga pajisjet që nuk do të riinstalohen, një pjesë mund të riblihet nga prodhuesi (në shumicën e rasteve) ose nga shoqëri të specializuara për rinovime;
- Përlllogarit se 50% e pajisjeve të mbetura do të rishiten për 25% të vlerës fillestare;

Formula për të përlllogaritur vlerën e rikuperuar të pajisjeve është:

$$PVR=1-((1-PRetro)+ PRetro \times CRetro)-PSold \times (1-PRetro) \times PVSold)$$

Ku:

- PVR është përqindja e vlerës së pajisjeve që do të rikuperohet mesatarisht
- $PRetro$ është përqindja e pajisjeve të ripërdorura pas rikonfigurimit
- $CRetro$ është kostoja e rikonfigurimit (përqindja e kostos së produktit)
- $PSold$ është përqindja e produkteve të shitura
- $PVSold$ është çmimi i shitjes për pajisjet e vjetra (përqindja e kostos së produktit)

Bazuar në shifrat e mësipërme, vlera e rikuperuar është

$$PRetro = 60\%$$

$$CRetro = 20\%$$

$$PSold = 50\%$$

$$PVSold = 25\%$$

Atëherë $PVR = 53\%$

Metodologjia përfshin dhe vlerësimin për shërbimet/punën bazuar në kostot standarde të fuqisë punëtore në Shqipëri dhe në BE si dhe bazuar në shërbimet e nevojshme që lidhen me rikonfigurimin e rrjeteve, instalimin, mbikqyrjen etj.